



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

i programeve IPA BNK Mal i Zi -
Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë
2014-2020 dhe 2021-2027

Prill
2026

CEREMONIA E INAUGURIMIT NË TROPOJË

PËRMBAJTJA

Edicioni i njëzetë e pestë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020 dhe 2021-2027. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian. Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA III BNK Mal i Zi - Shqipëri

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare të programit nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA III BNK Mal i Zi- Kosovë

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të zonës ndërkufitare të programit duke përmirësuar punësimin, lëvizshmërinë e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përtej kufijve; dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKSKB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- Një kapitull i ri për trashëgiminë kulturore në Tropojë.....2
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të dhe të IV-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri3
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë6
- CBC-House u hap në Prishtinë.....7
- U mbajtën takimet e Komitetit të Përbashkët Monitorues.....8

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.



Një kapitull i ri për trashëgiminë kulturore në Tropojë

Bashkia Tropojë inauguroi me sukses Muzeun Historik të Bajram Currit të revitalizuar me 26 mars të vitit 2026, duke shënuar një moment të rëndësishëm në zbatimin e projektit "Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë", financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Thirrjes së III-të për dërgimin e projekt-propozimeve brenda Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020.

Ngjarja mbledhi përfaqësues të institucioneve lokale dhe kombëtare, të Bashkimit Evropian dhe partnerëve ndërkufitarë, duke theksuar bashkëpunimin e fortë ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe turizmit të qëndrueshëm.

Në fjalën e tij hapëse, kryetari i bashkisë, **z. Rexhë Byberi**, theksoi rëndësinë e investimit për komunitetin lokal dhe vizitorët, duke deklaruar se projekti përfaqëson një aset të rëndësishëm për turizmin kulturor në Tropojë dhe pasqyron bashkëpunimin e suksesshëm me Komunën e Tivarit.




Folësit nënvizuan qasjen inovative të projektit, që kombinon ruajtjen e trashëgimisë me teknologjinë moderne. **z. Rando Kote**, Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit Territorial në SASPAC, vuri në dukje se integrimi i historisë me mjete digjitale si realiteti i shtuar krijon produkte turistike më tërheqëse, konkurruese dhe të qëndrueshme.



Ai gjithashtu theksoi forcimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë Tropojë në menaxhimin e projekteve, zhvillimin e turizmit dhe interpretimin e trashëgimisë.

Znj. Nada Pejović, drejtuese e Departamentit për programet bilaterale ndërkufitare në Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, theksoi

se projekti është një



shembull i fortë partneriteti mes Malit të Zi dhe Shqipërisë, duke kontribuar jo vetëm në ruajtjen e trashëgimisë së përbashkët kulturore, por edhe në krijimin e mundësive të reja për brezat e ardhshëm.



Znj. Carla Folgôa, përfaqësuese e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, theksoi rëndësinë më të gjerë të kulturës, duke vënë në dukje rolin e saj në nxitjen e dialogut, përfshirjes dhe mirëkuptimit reciprok si vlera themelore të Bashkimit Evropian dhe elemente thelbësore në rrugën e integritit evropian të të dy vendeve.



Përmes këtij projekti, Muzeu i Bajram Currit ka hapur rrugën drejt transformimit në një atraksion modern kulturor, me infrastrukturë të përmirësuar dhe mjete inovative interpretimi. Gjithashtu, në të dy vendet u zbatuan një gamë e gjerë aktiviteteve, përfshirë revitalizimin e vendeve të trashëgimisë, zhvillimin e rrugëve kulturore, krijimin e

produkteve turistike dhe prezantimin e përvojave digjitale dhe të realitetit të shtuar.



Projekti "Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë" ka kontribuar në rritjen e dukshmërisë dhe aksesueshmërisë së trashëgimisë kulturore në zonën ndërkufitare, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe duke mbështetur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Mal të Zi dhe Shqipëri.

Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të dhe të IV-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Forcimi i kapaciteteve monitoruese në zonën e Liqenit të Shkodrës

Gjatë një vizite në zyrat e Ndërmarrjes Publike për Parqet Kombëtare të Malit të Zi në Vraninë, të organizuar më 7 prill të vitit 2026, partnerët e projektit theksuan rezultatet konkrete të arritura përmes iniciativës së financuar nga BE-ja "Ujëmbledhësi i Liqenit të Shkodrës- një Reservuar i Biosferës Ndërkufitare".



Projekti mbështet menaxhimin e qëndrueshëm të pellgut të Liqenit të Shkodrës, një pasuri natyrore e përbashkët midis Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe liqeni më i madh në Ballkan, i njohur për rëndësinë ekologjike dhe biodiversitetin e tij.

Përmes financimit të BE-së, ekipi është pajisur me mjete moderne monitorimi që tashmë janë integruar në aktivitetet e përditshme operative. Këto burime rrisin kapacitetin e institucioneve për mbledhjen

e të dhënave, ndjekjen e ndryshimeve mjedisore dhe reagimin më efektiv ndaj sfidave në zonën e mbrojtur.



Iniciativa kontribuon në krijimin e një qasjeje të koordinuar ndërkufitare për menaxhimin e ekosistemit, duke mbështetur sistemet e përbashkëta të monitorimit dhe forcimin e bashkëpunimit institucional mes dy vendeve. Iniciativa është në përputhje me përpjekjet më të gjera për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit dhe për të promovuar turizmin e bazuar në natyrë në rajon.



Duke kombinuar investimet teknike me bashkëpunimin ndërkufitar, projekti përfaqëson një hap konkret drejt vizionit afatgjatë për krijimin e një rezerve biosfere ndërkufitare, duke forcuar njëkohësisht qëndrueshmërinë mjedisore dhe bashkëpunimin rajonal në zonën e Liqenit të Shkodrës.

Forcimi i bashkëpunimit për zhvillimin e turizmit

Është nënshkruar një marrëveshje partneriteti ndërmjet Federatës së Punëdhënësve të Malit të Zi dhe Organizatës Turistike së Zetës, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. Marrëveshja synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe aktorëve lokalë

të turizmit, me fokus të veçantë në promovimin dhe zhvillimin e Zetës si një destinacion turistik në zhvillim.



Përmes këtij partneriteti, të dy institucionet do të punojnë së bashku për të mbështetur bizneset lokale, për të nxitur sipërmarrjen dhe për të kontribuar në një ofertë turistike më konkurruese në rajon. Nisma pasqyron një angazhim të përbashkët për krijimin e mundësive të reja për rritje ekonomike, duke forcuar njëkohësisht rolin e turizmit si shtytës i zhvillimit lokal. Duke harmonizuar përpjekjet dhe ekspertizën, partneriteti pritet të kontribuojë në rritjen e dukshmërisë së vlerave kulturore dhe natyrore të Zetës dhe në promovimin e një qasjeje më të koordinuar për promovimin e turizmit. Kjo marrëveshje përfaqëson një shembull konkret se si bashkëpunimi institucional mund të mbështesë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, të forcojë ekonominë lokale dhe të krijojë vlerë të shtuar si për banorët ashtu edhe për vizitorët. Nisma zbatohet në kuadër të projektit "Turizëm me Varka të Aksesueshme", në bashkëpunim me Dhomën Shqiptare të Zejtarisë.

Për më tepër, si pjesë e të njëjtit projekt, u organizua një trajnim tregtar për zejtarë dhe artizanë në Vau të Dejës nga data 29 deri më 31 janar të vitit 2026. Trajnimi u fokusua në përmirësimin e kapaciteteve lokale për ndërtimin dhe modifikimin e varkave të aksesueshme, duke kontribuar në zhvillimin e turizmit gjithëpërfshirës rreth Liqenit të Shkodrës. Pjesëmarrësit u njohën me standardet moderne të aksesueshmërisë në dizajnin e varkave, përfshirë zgjidhje më të sigurta për hipje, ulëse të përshtatura, hapësira të përmirësuara lëvizjeje dhe qasje të orientuara nga përdoruesi. Aktiviteti theksoi gjithashtu rëndësinë e kombinimit të zejtarisë tradicionale me zgjidhje inovative dhe gjithëpërfshirëse në turizëm.



Trajnimi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të shërbimeve turistike më të aksesueshme në rajon, duke mbështetur njëkohësisht artizanët lokalë, promovuar përfshirjen sociale dhe forcuar qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit turistik në zonën e Shkodrës.

Mundësi të reja për të rinjtë dhe gratë përmes bashkëpunimit ndërkuftar

Në Lezhë është themeluar një Qendër për Orientim dhe Këshillim në Karrierë, duke krijuar një hapësirë të dedikuar ku të rinjtë, gratë dhe personat e papunë marrin jo vetëm informacion, por edhe udhëzime, motivim dhe ngrisin vetëbesimin për të ndërmarrë hapa më të sigurt drejt punësimit.



Përmes këshillimit profesional dhe orientimit të personalizuar në karrierë, përfituesit po zbulojnë mundësi të reja zhvillimi të përshtatura me nevojat reale të tregut të punës. Falë partneritetit me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe mbështetjes së Drejtorisë Rajonale të Punësimit në Lezhë, ndërhyrjet e projektit në Lezhë kanë sjellë tashmë rezultate konkrete.



20 të rinj të certifikuar në kursin "Digital Skills" dhe "Soft Skills". 15 të rinj kanë ndjekur praktika profesionale



Konkretisht, gjithsej 20 të rinj janë certifikuar në programe trajnimi për aftësi digjitale dhe aftësi "të buta", duke u pajisur me kompetenca që kërkohen gjithnjë e më shumë në tregun e punës.

Gjithashtu, 15 të rinj përfunduan praktika një mujore në kompani të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT) në Tiranë, duke fituar përvojë të drejtpërdrejtë profesionale dhe njohje me realitetin e punës.



Pesëmbëdhjetë gra morën pjesë në trajnime për punësueshmëri të fokusuar në komunikim, punë në ekip dhe shërbime hotelerie, përfshirë shërbimin, recepsionin dhe mirëmbajtjen, ndërsa 9 prej tyre tashmë janë në proces punësimi në bizneset lokale në Lezhë, duke bërë hapa të rëndësishëm drejt pavarësisë ekonomike.

Në të njëjtën kohë, i njëjti model po zbatohet në Mal të Zi, ku Enti i Punësimi të Malit të Zi po mbështet të rinjtë dhe gratë përmes zhvillimit të aftësive për punësim dhe sipërmarrje.

Ky bashkëpunim ndërkufitar dëshmon se investimi të njerëzimit mbetet një nga rrugët më efektive drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirjes sociale, duke siguruar që askush të mos mbetet pas.



Projekti "Nxitja e Punësimi të Denjë për të Rinjtë dhe Personat e Papunë në Zonën Ndërkufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë" zbatohet nga World Vision Albania, Enti i Punësimi të Malit të Zi dhe Agjencia Kombëtare Shqiptare për Punësim dhe Aftësi, dhe synon fuqizimin e të rinjve dhe personave të papunë përmes trajnimeve në soft skills dhe aftësi digjitale, praktikave profesionale dhe mbështetjes sipërmarrëse.

Trajnimet për zhvillimin e planeve të biznesit u përfunduan me sukses

Faza e dytë e zhvillimit të planeve të biznesit për gratë sipërmarrëse pjesëmarrëse në projektin "Zhvillimi i Mikro-ndërmarrjeve të Grave në Zonën Ndërkufitare" është përfunduar me sukses. Aktiviteti mbledhi pjesëmarrëse nga zona ndërkufitare e Malit të Zi dhe Shqipërisë, duke u ofruar atyre mundësinë të zhvillojnë më tej idetë e tyre të biznesit dhe t'i transformojnë ato në plane biznesi të strukturuar dhe të qëndrueshme.



Nën mentorimin e ekspertëve, pjesëmarrëset punuan intensivisht në përmirësimin e koncepteve të tyre të biznesit përmes udhëzimeve praktike dhe sesioneve individuale të mentorimit. Secila pjesëmarrëse pati mundësinë të prezantojë idenë e saj sipërmarrëse dhe ta zhvillojë atë në një plan biznesi gjithëpërfshirës, i cili do të shërbejë si bazë për aplikim në thirrjen e hapur të Komunes së Ulqinit për mbështetje. Procesi i mentorimit u fokusua në forcimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve në planifikim biznesi, qëndrueshmëri financiare dhe pozicionim në treg. Përmes komenteve konstruktive dhe këshillave praktike, ekspertët mbështetën gratë sipërmarrëse në përmirësimin dhe forcimin e koncepteve të tyre të biznesit, duke i përgatitur për fazat e ardhshme të zhvillimit të biznesit.



Punëtoritë u karakterizuan nga një atmosferë shumë pozitive dhe bashkëpunuese, ku pjesëmarrëset shprehën entuziazëm të madh, motivim të shtuar dhe përkushtim ndaj zhvillimit të rrugëtimit të tyre sipërmarrës. Përveç përmirësimi të aftësive të biznesit, aktiviteti

kontribuoi në rritje dhe mbështetje reciproke ndërmjet grave sipërmarrëse nga rajoni ndërkufitar.

Shikoni videon nga një prej sesioneve [këtu](#).

Projekti "Zhvillimi i Mikro-ndërmarrjeve të Grave në Zonën Ndërkufitare", zbatohet nga Komuna e Ulqinit, Monitoring Group Ulcinj – MogUL dhe Code Partners nga Shkodra.

Forcimi i aftësive të komunikimit dhe punës në ekip

Në kuadër të zbatimit të projektit *P.O.W.E.R.*, Caritas Albania, në partneritet me Down Syndrome Albania, organizoi sesionin e tretë të trajnimit për personat me aftësi të kufizuara nga data 23 deri më 26 shkurt të vitit 2026, me fokus në komunikim dhe punë në ekip. Trajnimi synoi forcimin e aftësive ndërpersonale, përmirësimin e bashkëpunimit dhe ndërtimin e besimit reciprok ndërmjet pjesëmarrësve. Përmes ushtrimeve praktike, aktiviteteve në grup dhe sesioneve interaktive, pjesëmarrësit hulumtuan teknika efektive komunikimi dhe fituan një kuptim më të thellë mbi rëndësinë e punës në ekip dhe rolin që secili individ luan brenda dinamikës së grupit.



Sesionet u drejtuan nga **znj. Enkeleida Mataj**, e cila e udhëhoqi trajnimin në një mjedis gjithëpërfshirës dhe motivues që inkurajonte diskutimin e hapur, pjesëmarrjen aktive dhe reflektimin personal. Gjatë aktivitetit katërditor, pjesëmarrësit demonstruan nivel të lartë angazhimi, bashkëpunimi dhe motivimi për të forcuar kapacitetet e tyre dhe përmirësuar aftësitë komunikuese. Atmosfera pozitive dhe mbështetëse kontribuoi në ndërveprim më të madh ndërmjet pjesëmarrësve dhe përforcoi vlerën e punës në ekip si në kontekst personal ashtu edhe profesional.



Projekti "P.O.W.E.R. – Personat me Aftësi të Kufizuara: Mundësi të Reja për Punë, Punësueshmëri dhe Rehabilitim Profesional, vazhdon të mbështesë zhvillimin e kompetencave që kontribuojnë në rritjen e

pavarësisë, përfshirjes sociale dhe mundësive të punësimit për personat me aftësi të kufizuara.

Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Shenja të reja interpretuese

Në prill, përfaqësuesit e CFCU-së, Ministrisë së Çështjeve Evropiane dhe PTS-së patën mundësinë të vizitojnë aktivitetet e zbatuara në kuadër të projektit "Rilindja Kulturore nga Liqeni I Shkodrës në Kosovë (Time Travel)", një iniciativë ndërkufitare që promovon trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe përvojat e qëndrueshme turistike ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës.



Shenja të reja interpretuese u vendosën pranë Liqenit të Shkodrës, duke ndihmuar vizitorët të kuptojnë më mirë rëndësinë kulturore dhe natyrore të zonës. Sinjalistika kontribuon në krijimin e një përvoje turistike më të qasshme dhe tërheqëse, duke inkurajuar vizitorët të eksplorojnë rajonin në mënyrë të përgjegjshme dhe të vlerësojnë lidhjet e tij të pasura historike.



Projekti, i zbatuar nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF), Qendra për Iniciativa të Turizmit të Qëndrueshëm (CSTI) Mali i Zi, Organizata Kombëtare e Turizmit (NTO) e Malit të Zi dhe Komuna e Klinës, vazhdon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar duke lidhur monumentet

kulturore, traditat lokale dhe praktikat e turizmit të qëndrueshëm në një histori të përbashkët rajonale.



Edicioni i III-të i Festivalit Outdoor në Pejë

Edicioni i tretë i Festivalit Outdoor në Pejë do të organizohet nga data 11 deri më 14 qershor të vitit 2026, duke konfirmuar ndikimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura përmes projektit "Turizëm për të Ardhmen". Festivali vazhdon të rritet si një platformë që promovon turizmin e qëndrueshëm, rekreacionin në natyrë dhe bashkëpunimin rajonal ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës.



Fillimisht i nisur përmes bashkëpunimit të OJQ-së REA Prishtina, Shoqatës së Alpinistëve "Đeravica", Komunës së Kollashnit dhe Institutit për Sipërmarrje dhe Zhvillim Ekonomik, iniciativa synonte forcimin dhe markimin e sektorëve turistikë të Pejës dhe Kollashnit përmes ofertave inovative dhe të qëndrueshme turistike.

Organizimi i suksesshëm i festivalit në vitet 2024 dhe 2025 demonstroi bashkëpunimin e fortë ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve lokalë të turizmit. Përmes aktiviteteve si ecja malore, çiklizmi, alpinizmi, paraglajdingu dhe turet në shtigjet kulturore, vizitorët patën mundësinë të eksploronin trashëgiminë

natyrore dhe kulturore të rajonit, duke promovuar njëkohësisht praktika të turizmit të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

Vazhdimi i festivalit në vitin 2026 thekson qëndrueshmërinë dhe vlerën afatgjatë të rezultateve të projektit, veçanërisht në aspektin e ruajtjes së aktiviteteve të ekoturizmit, mbështetjes së operatorëve lokalë të turizmit dhe rritjes së dukshmërisë së rajonit ndërkufitar si destinacion për turizëm aventurier dhe kulturor. Ai gjithashtu pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të partnerëve lokalë për të zhvilluar më tej produkte turistike që inkurajojnë udhëtimin e përgjegjshëm, ruajtjen e trashëgimisë dhe krijimin e mundësive ekonomike për komunitetet lokale.



Shikoni videon promovuese për Edicionin e III-të [këtu](#).

CBC-House u hap në Prishtinë

Hapja zyrtare e CBC House në Prishtinë shënoi një hap të rëndësishëm përpara në forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe partneriteteve rajonale në rajon.



E vendosur në Rrugën Sejdi Kryeziu, Hyrja 54, Kati 2, CBC House do të funksionojë si një hapësirë e përbashkët e dedikuar për bashkëpunim, dialog dhe mbështetje për përfituesit, institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët lokalë të angazhuar në iniciativat e bashkëpunimit ndërkufitar. Në keto ambiente është e vendosur edhe Zyra Antene e Programit IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi –

Kosovë, duke forcuar më tej rolin e tij si pikë qendrore për koordinimin e programit, komunikimin dhe angazhimin e palëve të interesuara.



Hapja e CBC House përfaqëson një kontribut të rëndësishëm drejt rritjes së dukshmërisë dhe qasshmërisë së programeve të bashkëpunimit ndërkuftar në rajon, duke inkurajuar njëkohësisht pjesëmarrje më të madhe nga institucionet lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera relevante të interesuara. Partnerët, përfutuesit dhe palët e interesuara ftohen të përdorin CBC House si një platformë për rrjetëzim, shkëmbim idesh dhe zhvillimin e iniciativave të ardhshme të bashkëpunimit.



U mbajtën takimet e Komitetit të Përbashkët Monitorues

Takimet e dyta të Komitetit të Përbashkët Monitorues (KPM) në kuadër të Programeve IPA III të Bashkëpunimit Ndërkuftar Mali i Zi – Kosovë dhe Mali i Zi – Shqipëri u mbajtën gjatë tremujorit të parë të vitit 2026.



Gjatë takimeve, anëtarët e KPM-së shqyrtuan dhe diskutuan raportet përfundimtare të zbatimit për alokimet e vitit 2017 në të dy programet. Pas diskutimeve, anëtarët e JMC-së miratuan unanimisht raportet përfundimtare përkatëse të zbatimit për alokimin e vitit 2017.



Takimet shërbyen gjithashtu si mundësi për shkëmbim mendimesh mbi mësimet e nxjerra dhe aktivitetet e ardhshme që lidhen me proceset e vlerësimit të Thirrjeve të para për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të Programeve brenda perspektives financiare IPA III.



Takimi i dytë i KPM-së për Programin IPA BNK Mali i Zi – Kosovë u mbajt në format hibrid më 27 mars 2026 në Prishtinë dhe online. Takimi i dytë i KPM-së për Programin IPA III CBC Mali i Zi – Shqipëri u mbajt online më 2 prill 2026.



Takimet e ardhshme të KPM-së për të dy programet planifikohen të mbahen në Mal të Zi.

Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministarstvo
evropskih
poslova



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Montenegro
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Nersada MANDIJA

Zyrtare Projekti, Antenë
E-mail: nersada.mandija@saspac.gov.al

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: CBC House – Rruga Sejdi Kryeziu, Hyrja 54, Kati 2, Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 43 800 389;

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc_mne_alb



@cbc.mne.kos



@cbc_mne_kos

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Albania

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Kosovo